



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
MINISTARSTVO OBRAZOVANJE, NAUKE,TEHNOLOGIJE I INOVACIJE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE, TECHNOLOGY AND INNOVATION

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, duke u bazuar në nenin 2 të Marrëveshjes së Grantit TF0C3867-XK të nënshkruar me datën 28 qershor 2024 nga Republika e Kosovës dhe Banka Botërore dhe në vendimin Nr. 01B-246 datë 23.12.2024, bën

THIRRJE PËR APLIKIM TË FAMILJEVE TË REGJISTRUARA NË SKEMËN E
ASISTENCËS SOCIALE
NGA KOMUNA E PRISHTINËS, LIPJANIT DHE GJILANIT
NË PILOTIMIN E PROGRAMIT TË KUPONËVE

Datë: 23.01.2024

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka filluar zbatimin e Pilotimit të Programit të Kuponëve. Programi ka për qëllim të përmirësojë qasjen e fëmijëve 3 deri në 5 vjeç në Institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme (IEFH) nga familjet të cilat janë të regjistruara në Skemën e Asistencës Sociale (SAS).

Nëpërmjet Programit të Kuponëve, MASHTI do të rimbursoj pagesën e edukimit dhe transportit për fëmijët e përzgjedhur.

Programi i Kuponëve do të zgjas nga muaji dhjetor 2024 deri në qershor 2027. Ndërsa faza e pilotimit do të zgjas për 6 muaj nga fillimi i vijimit të edukimit nga fëmijët në IEFH.

Komunat e përzgjedhura për pilotim janë: 1) Komuna e Prishtinës; 2) Komuna e Lipjanit; dhe 3) Komuna e Gjilanit.

Familjet e regjistruara në SAS të cilat banojnë në këto komuna ftohen të aplikojnë në Programin e Kuponëve në mënyrë që të përfitojnë nga programi.

Kriteret për aplikim janë:

Familja duhet të jetë e regjistruar në SAS si përfituese;

- Të ketë të paktën një fëmijë të moshës nga 3 deri në 5 vjeç në kohën e regjistrimit në IEFH. Moshë e fëmijës llogaritet nga data e ofrimit të shërbimit në IEFH, jo nga data e aplikimit në Program. Rrjedhimisht prindi apo kujdestari ligjor mund të aplikoj edhe para se fëmija të ketë mbushur moshën 3 apo 5, duke filluar nga 2 vjet e 6 muaj deri në moshën 4 vjet e 6 muaj. Me kusht që vijimin në IEFH ta nis në moshën 3 vjeçare dhe ta përfundoj kur fëmija fillon edukimin e detyrueshëm parafillor pas moshës 5 vjeçare;
- Fëmija duhet të ketë vendbanimin në komunën ku aplikon për ta vijuar IEFH.

Të gjithë fëmijët të cilët i plotësojnë kriteret e lartpërmendura do t'i nënshtrohen përzgjedhjes në mënyrë të automatizuar të rastësishme në pajtim me Udhëzuesin e Programit të Kuponëve të miratuar me vendimin Nr. 01B-246 datë 23.12.2024.

Shpenzimet të cilat do të mbulohen nga programi:

- Programi do të mbuloj pagesën e IEFH për fëmijën për gjashtë muaj të pilotimit;
- Pagesën për transport për fëmijët të cilët nuk janë në gjendje të udhëtojnë të sigurt të shoqëruar nga prindërit ose kujdestari i tyre ligjor, distanca e të cilëve është së paku 4 kilometra për në IEFH.

Shuma e pagesës së transportit do të përcaktohet nga Komisioni për Vlerësimin e Aplikimeve për Programin e Kuponëve në shumën prej 60 euro deri në 100 euro për fëmijë varësisht nga komuna përkatëse dhe distanca rrugore.

Procedura e aplikimit:

Aplikimi realizohet vetëm nëpërmjet e-Kosova; <https://ekosova.rks.gov.net/Security?ReturnUrl=%2F596>

Aplikuesit mund të jenë vetëm prindërit apo kujdestarët ligjorë të fëmijëve.

Aplikuesit mund të aplikojnë për më shumë se një fëmijë.

Të dhënat dhe dokumentet e kërkuara në procedurë të aplikimit janë:

- Emri Mbiemri i prindërve ose kujdestarit;
- Adresa;
- Regjioni;

- Numri i kontaktit;
- Numri i fëmijëve për të cilët ata kërkojnë mbështetje nga Programi i Kuponit;
- Emri Mbiemri i fëmijës/fëmijëve;
- Karta e ndihmës sociale;
- Nëse aplikuesi është kujdestar ligjor (dhe jo prindi) atëherë duhet të ngarkohet dëshmia për kujdestarinë ligjore;
- Dëshmia e vaksinimit, pasaporta e vaksinimit të fëmijëve;
- Përzgjedhja e IEFH brenda komunës së aplikuesit.
- Të dhëna nëse fëmija është me aftësi të kufizuara;
- Distanca nga vendbanimi për në IEFH.
- Nëse ka nevojë për transport.

Afati për aplikim

Aplikimi është i hapur për 21 ditë nga data 23.01.2025 dhe përfundon me datën 12.02.2025.

Komisioni për Vlerësimin e Aplikimeve për Programin e Kuponëve do të përpilojë listën përfundimtare të përfituesve brenda 15 ditëve pas mbylljes së procesit të aplikimit. Vendimi do të publikohet në kanalet zyrtare të MASHTI-t dhe do të ndahet me të gjithë aplikantët përmes e-Kosova.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrin e telefonit: 038 200 65048 dhe/ose duke dërguar e-mail në adresën: programiikuponave@rks-gov.net.